

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 GJYKATA E SHKALLES SE PARE
 RRETHIT GJYQESOR ELBASAN
 NR.REGJ. THEM 2181/4211 (11217-01795-13)
 NR.VENDIMI 790 (13-2011- 1664)

V E N D I M
“ NE EMER TE REPUBLIKES “

Gjykata e Shkalles se Pare , prane rrethit Gjyqesor Elbasan , me trup gjykues te perber nga :

Gjyqtar– TAULANT Tafa

Ne prani te sekretares **Klarita Bicoku** , sot me dt 07.04.2011 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike ceshtjen civile qe i perket;

PADITES : Shoq ” Viktoria – Invest ” sh.p.k Elbasan , perfaqesuar me prokur te posacme nr 1381 rep dt 16.07.2010 nga Dorian Molloholli.

E PADITUR : Bashkia Elbasan perfaqesuar me autorizim dt 06.10.2010 nga Rovena Beqiraj, (**ne mungese**).

OBJEKTI : 1- Detyrimi i pales se paditur te demshperbleje palen paditese per humbjet pasurore qe i kane ardhur si rezultat i begatimit pa shkak;

2- Permbushje detyrimi kontraktor.

BAZA LIGJORE : Nenet 655, 656 vijues, neni 419 vijues dhe neni 300 vijues te K.K.Civile , si dhe nenet 31, 32 , 153 vijues te K.PR.Civile.

Ne peramendim te shqyrtimit gjyqesor, te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit te ciles paditese shoq ” Viktoria – Invest ” sh.p.k – Elbasan , **ne mungese** te pales se paditur Bashkia Elbasan, gjykata pasi degjoi perfaqesuesin e pales paditese i cili cerkoi pranimit e paditese sipas objektit te saj, si shqyrtoi provat e ndodhura ne tosjte dhe ceshtjen ne reres:

V E R E N

Pala paditese shoq ” Viktoria – Invest ” sh.p.k Elbasan ka paraqitur nje kerkesa padi prane kesaj gjykate , sipas te ciles kerkon, detyrimi i pales se paditur te demshperbleje palen paditese per humbjet pasurore qe i kane ardhur si rezultat i begatimit pa shkak te te paditurit ne lidhje me volumet shtese te punimeve te kryera prej saj . *largim dhe transportim te mbetjeve urbane, sistemim i mbeturinave urbane ne vendgrumbullim* si dhe te permbushe detyrimin kontraktor, konkretisht detyrimet qe rrjedhin nga neni 16 i kontrates se siper marrjes dt 15.09.2006, lidhur midis paleve , si pasoje e ndryshimit te cmimeve te zerave

kryesore te kostos , ne zbatim te ndryshimeve ligjore te ndodhura pas nezhurimit te kontrates .

Gjykata pasi studioi materialet e ceshtjes civile nr 2181/211 Akti i paraqitur per gjykim , ne baze te nenit 36 te K.PR.civile , ne te cilin parashikohet se *juridiksionin e gjykatave hyjne te gjithe mosmarreveshjet mosmarreveshje te tjera te parashikuara ne kete kod e ne lidhje te veçanta . Duke qene se ndodhemi perprara nje mosmarreveshje me karakter civil dhe qese ndergjyqese , cmoi kryesisht se ceshtja e paraqitur eshte ne juridiksionin gjyqesor*

Persa i perket kompetences lendore , mbesatetur ne nenin 41 te K.PR.civile ne te cilin parashikohet shprehimisht se *ne kompetence te Gjykatës së Elbasanit Pare jane te gjitha mosmarreveshjet civile e mosmarreveshjet mosmarreveshje te tjera te parashikuara ne kete kod e ne ligje te tjera. duke qene se ceshtja eshte e paraqitur per shqyrtim eshte nje mosmarreveshje civile , gjykata eshte kompetente per pikpamja lendore per shqyrtimin e kesaj ceshtjeje*

Lidhur me kompetencen tokesore , ne baze te nenit 49 te K.PR.civile *qese padituri eshte person juridik , padite ngrihen ne gjykate te vendit ku gjykatë juridik ka qendren e tij. Duke qene se pala e paditur ne kete gjykim eshte Bashkia ne Elbasan , dhe nga pikpamja e kompetences tokesore , ceshtja e paraqitur duhet te merret ne shqyrtim nga kjo gjykate.*

Gjithashtu, gjykata ne veshtrim te neneve 71, 72 dhe 73 te K.PR.Civile cmoi se nuk ekzistojne per te shkaqe papajtueshmërie ose perjashtimi ne gjykim.

Ne baze te nenit 35/a te K.PR.Civile , gjykimi u zhvillua me trup gjyqesor perbërë nga nje gjyqtar , pasi qe ne seance perqatimore sipas nenit 35 te K.PR.Civile, palet nuk kerkuan qe gjykimi te zhvillohet me trup gjyqesor i perbere prej tre gjyqtaresh, pasi dhane pelqimin qe ceshtja te zhvillohet nga grup gjyqesor vetem e pasqyruar dhe ne deklarata e perpluara prej tyre.

Pala paditese shoq " Viktoria - Invest " sh.p.k Elbasan ne seance gjyqesore paraqiti nje kerkese per shtimin e objektit te padise bazuar ne nenin 185 te K.PR.Civile, kerkese e cila pasi ju nenshtrua debatit gjyqesor me palen e perballuar Bashkia Elbasan, u pranua nga gjykata ne respektim te detyrimeve te kontrates ne nenin 185 te K.PR.Civile.

Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar se:

Pala paditese shoq " Viktoria - Invest " sh.p.k Elbasan eshte shoqet e drejtes tregtare Shqiptare i njohur dhe regjistruar si i tille konforme legjislacionit tregtare ne Shqiperi , me vendimin nr 29022 dt 07.02.2003 te Gjykatës së Elbasanit Gjyqesor Tirane. Me regjistrimin ne gjykate sipas tregullimit te parashikuar ne K.Civil (neni 29) dhe ligji " Per shogerite Tregtare", nga ky cast pala paditese fituar personalitet juridik , zotesi te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrimet e cila perligj dhe paraqitjen e saj si subjekt juridik ne qarkullimin civil.

Ne zela koaden, midis pales paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k Elbasan dhe pales se paditur Bashkia Elbasan, me dt 15.09.2006 eshte lidhur kontrata sipermarrjes "*Per kryerjen e sherbimit te pastrimit te qytetit Elbasan* ", ku pala e paditur Bashkia Elbasan perfaqeson *entit prokurues* , ndersa pala paditese perfaqeson *sipermarresin* .

Pala paditese shoq " Viktoria -- Invest " sh.p.k , ne cilesine e sipermarresit merr persiper *kryerjen e sherbimeve* qe konsiton pastrimin , grumbullimin dhe largimin publik te mbeturinave sipas kushteve teknike te percaktuara ne kontrate, *mbledhjen e muanimeve* qe konsiston ne sasine vjetore te sherbimeve qe do te kryhen nga sipermarresi, nder te tjera dhe sasine e mbetjeve urbane (sasia ne ton/ per cdo dite) si dhe *vleresimin e operacioneve te punimeve* qe konsiton ne vleresimin e shkrave te punes per cdo sherbim (volume vjetor, frekuenca dhe vlera) te percaktuara ne nenet 5,6 dhe 7 te kontrates se sipermarrjes .

Pala paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k Elbasan , gjate parashtrimeve te saj ne senance gjyqesore , kerkoi pranimin e padise , me pretendimin se :

Pala paditese ka fituar te drejten, sipas kontrates se sipermarrjes dt 15.09.2006 per *largim dhe transportim te mbetjeve urbane, sistemim i mbeturinave urbane ne vendgrumbullim*, per qytetin e Elbasanit. Sipas kontrates , nenin 6 te kontrates percaktohet, largimi dhe transportimi i mbeturinave urbane 27 375 ton ne vit, cdo dite, sistemimi i mbeturinave urbane ne vendgrumbullim: 27 375 ton ne vit, cdo dite, ndersa ne nenin 7 te kontrates (vleresimi i shkrave te punes), transportimi i mbeturinave urbane nga kontenieret ne busnen e depozitimit vleresohet me 1155 leke/ton volumi 27 375 ton, frekuenca 365 dite, vlera 31 618 125 leke, si dhe mirembajtja e fushes se depozitimit te mbeturinave urbane vleresohet me 115 leke/ton volumi 27 375 ton, frekuenca 365 dite, vlera 3 48 125 leke.

Ne fakt shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k. pretendon se ka realizuar nje volum pune mbi ate te ngarkuar ne kontrate, pretendim te cilin ja kane paraqitur bashkise Elbasan, qe ne momentin fillestar te zbatimit te kontrates, pasi sasia e ofrimit e grumbullimit dhe largimit te mbeturinave urbane nga mjetet e shoqerise rezultome shume me te larta nga ajo e percaktuar ne kontraten e lidhur me Bashkine Elbasan.

Ne respektim te detyrimeve kontraktore duke mos qene ne dijeni te volumeve qe shoqeria do te realizonte *ne fakt*, nga zbatimi i kushteve te kontrates paditese ka fituar te kryeje punimet . Ne kete menyre sipas pretendimeve te pales paditese ne gjykim, ndermjet paleve jane zhvilluar dy lloj marredheniesh te ndryshme nga njera tjetra . Marredhenia e pare kontraktore normohet nga kontrata dt 15.09.2006 dhe ka te bej me *largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane, sistemimin e mbeturinave urbane ne vendgrumbullim*, ndersa marredhenia e dyte

eshte nje marredhenie jashte kontraktore qe lidhet me qeverien e bashkis se Elbasan mbi sasine e percaktuar ne kontrate.

Menjehere sapo nga shoqeria eshte konstatuar nje fakt i tije, qe vlon ne punes qe po kryhej ishte me e larte se ajo e percaktuar ne kontrate (se punes e paguar), nga ana e pales paditese, jane bere kerkesa te vazhdueshme neper nje shkresave te dt 22.11.2006, dt 10.01.2007, dt 06.05.2007, dt.28.10.2007, dt 04.01.2008 dhe dt.26.10.2009, sipas te cilave pala paditese ka kerkuar rritjen e kontrate ne masen 20 %, ne perputhje me ligjin nr 9543 dt.29. 2005 "Per Prokurimin Publik".

Sipas shpjegimeve te pales paditese demit qe i eshte shkatuar nga pala paditur Bashkia Elbasan eshte jashte kontraktore, sepse vlera e kontrates ne shiper marrjes eshte permbushur plotesisht. Lidhur me vleren shtese te punes kryer, pala paditese ka zgjedhur begatimin pa shkak, pasi nuk rezulton te ketë asnjë objekt tjetër padie apo nje shkak tjetër ligjore qe te mund te zgjidhet me mosmarreveshje te lindur midis pales paditese dhe pales se paditur ne gjykim.

Sipas pales paditese begatimi pa shkak i pales se paditur ka ardhur si pasigje e volumeve shtese te punimeve lidhur me largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane, sistemimin e mbeturinave urbane ne vendgrumbullim, ne ne fakt shkak i qe dobi te pales se paditur, e cila pa ndonje shkak te ligjshem shtese begatuar ne kontrate paditesit.

Me qellimim percaktim e demit te pesuar, u krye dhe nga ai ekspertizim nga ana e gjykates, ne zbatim te kriterëve te percaktuar ne nenin 124 i pjesës II të K.PR.Civile.

• Pala e paditur gjate parashkrimeve te saj ne seance gjyqesore kerkoi rrezimin e padise me pretendimin se :

- Volumet e punimeve te kryera nga pala paditese ku percaktohet dhe vlon ne largimit dhe transportimit te mbetjeve urbane (75 ton/dite) e percaktuar ne kontrate eshte pranuar me mareveshje nga vete Shoq "Victoria - Invest"
- Bashkia Elbasan nuk i ka kerkuar shoqerise te kryeje volume me shume se ato qe e percaktuar ne kontrate.
- Ne peshimet e kryera nga Bashkia, ne periudha te ndryshme kohore gjate realizimit te kontrates se pastrimit, jane futur edhe zona te hapura jashte kontrates.
- Rritja e kosos si rezultat i rritjes se pagave minimale dhe referuese nuk eshte e sakte pasi shoqeria, pala paditese ka kryer sherbimet sipas kontrates me nje numer te kufizuar punonjesish, dhe pagat e punonjesve rregullohen nga marredheniet e punes midis tyre dhe shoqerise " Viktoria -- Invest", me cilesine e punedhenses.
- Konkluzioni i eksperteve eshte teorik, dhe i referohet studimit te Ministrise se Mjedisit, i cili percakton sasine e mbetjeve urbane ne qytetin e Elbasanit 33 ton/dite me koeficient - 1.1 kg mbetje urbane ne dite per banore.

Gjykata per zgjedhjen e ketij konfliktit gjyqesore do ti referohet institutit te begatimit pa shkak , institut i cili parashikohet nga neni 655 e vijues i K.Civile.

Ne nenin 655 te Kodit Civil parashikohet se, "Personi qe pa nje shkak te ligjshem, ka fituar ose ka kursyer diçka ne dem te nje personi tjetër, detyrohet te shperbleje baze te fundit per humbjet pasurore qe ka pesuar, brenda caqeve te begatimit".

Ne nenin 658 te Kodit Civil parashikohet se, " Padia per begatimin pa shkak nuk mund te ngrihet kur i demtuari mund te ngreje nje tjetër padi per te kerkuar superblimin e demit te pesuar "

Gjykata cmon se bazuar ne nenin 655 te K.Civil , permendur me lart , qe te ndodhemi para institutit juridik te begatimit pa shkak duhet te ekzistojne disa kushte pozitive dhe negative (*kumulative*). Kushtet positive jane :

- 1- Nje person te jete pasuruar dhe nje tjetër te jete demtuar.
- 2- Pasurimi i nje personi duhet te rrjedhe nga demtimi i personit tjetër (lidhja shkakësore).
- 3- Pasurimi nuk duhet te kete ndodhur ne baze te nje shkakut te ligjshem, pra te mungoje nje shkak i ligjshem ose ai te kete ekzistuar dhe te jete shuar ne nje periudhe te mevonshme.

Nga ana tjetër, qe te ndodhemi para institutit juridik te begatimit pa shkak duhet te permbushet edhe nje kusht negativ qe eshte,

4. Begatimi i njerit dhe demtimi i tjetrit te mos jete bere me faj *(pakuqies ose dashje)*, pasi ne te kundert do te kishim te benim me institutin juridik civil te shkakimit te demit (nenet 608 – 610 te K.Civil etj).

Gjykata pasi shqyrtoi provat ne reresi , degjoi pretendimet e paleve dhe kontrazionet perfundimtare te paraqitura prej tyre , **cmo se** : Pala paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k Elbasan eshte subjekt i te drejtes tregtare Shqiptare i njohur dhe regjistruar si i tille konforme legjislacionit tregtare ne Shqiperi , me vendimin nr 29022 dt 07.02.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Me regjistrimin ne gjykate sipas rregullimit te parashikuar ne K.Civil (neni 29) dhe ligji " Per shoqerite Tregtare", nga ky cast pala paditese ka fituar personalitet juridik , notesi te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrime gje e cila perligj dhe paraqitjen e saj si subjekt juridik ne qarkullimin civil.

Misar nga ky fakt, midis pales paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k Elbasan dhe pales se paditur Bashkia Elbasan, me dt 15.09.2006 eshte lidhur kontrata sipermarrjes "*Per kryerjen e sherbimit te pastrimit te qytetit Elbasan* " , ku pala e paditur Bashkia Elbasan perfaqeson *entit prokurues* , ndersa pala paditese perfaqeson *sipermarresin* .

Pala paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k , ne cilesine e sipermarresit ka marre persiper kryerjen e sherbimeve qe konsiston pastrimin , grumbullimin dhe largimin publik te mbeturinave sipas kushteve teknike te percaktuara ne kontrate, si dhe volumeve e punimeve qe konsiston ne sasine vjetore te sherbimeve qe do te

kryhen nga sipermarrësi, nder te tjera dhe sasine e mbeteve urbane ne kontrates eshte percaktuar ne vleren 75 ton/dite.

Ne respektim te detyrimeve kontraktore si dhe duke marrë vesh ne detyrime te faktit se volumet e punes do te rezultojn me diferencat te medha , pala paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k Elbasan, ka filluar kryerjen e punimeve ne objektin te percaktuar ne kontraten e sipermarrjes lidhur me mbeteve urbane ne respektim objektit te kontrates ishte dhe nje nder detyrimet e paditeseve te percaktuara dhe ne kontrate , konkretisht ne nenet 6, 7 dhe 8 te saj.

Gjate zbatimit nga pala paditese te kontrates, kane rezultuar volumet e punes . Ne kete menyre, nepermjet veprimeve te kryera nga vete pala e paditese Bashkia Elbasan , jane dertuar dy lloj marredheniesh juridike te ndryshme . Gjate njera- tjetra . **Marredhenia e pare , kontraktore** gjen rregullimin dhe kontrole nga kontrata e sipermarrjes dt 15.09.2006 . Kjo marredhenie lidhet me zbatimin e objektit te kontrates, ne vecanti me sasine e largimit dhe transportimit e mbeteve urbane, sistemimit te mbeturinave urbane ne vendgrumbullim, per qytetin Elbasanit , ne masen 75 ton/ dite . **Marredhenia e dyte ,eshte nje marredhenie jasht kontraktore**, qe ka te bej me volumet shtese te punes se kryer nga pala paditese per te cilat nuk rezultojn te jete lidhur kontrate midis paleve . Per kete arsye te kerkimet qe kane te bejne me kete fakt , nuk mund te gjejne reference ligjore te marredhenien kontraktore te sipermarrjes .

Pala paditese menjehere pas fillimit te realizimit te objektit te kontrates eshte vene ne dijeni te faktit se sipermarrja e tij, per largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane, sistemimin e mbeturinave urbane ne vendgrumbullim, per qytetin e Elbasanit, nuk mund te zbatohet mbi bazen e volumeve te punes te percaktuar dhe formuluar ne kontraten e sipermarrjes me pala paditese . Gjatë kësaj evidentuar situaten faktike, pala paditese, shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k ka paraqitur ne menyre te perseritur prane pales se paditur, Bashkise Elbasan te verifikimet e nevojshme me ane te nje komisioni , lidhur me sasine e mbeteve urbane ne qytet. Ne vijim te ketij kerkimi, me urdherin e Kryetarit Bashkise Elbasan, pasqyruar ne shkresen nr.818 prot. dt.05.02.2008, "**Mbi percaktimin e peshes ditore te mbetjeve urbane ne qytet**", eshte vendosur ngritja e nje komisioni per percaktimin volumit real ditor te mbetjeve urbane qe grumbullohen, transportohen e sistemohen. Komisioni i Bashkise ka kryer ne dt.02.05.2008 procesin e percaktimit te volumit te mbetjeve urbane (shkresa nr.137/ dt.09.05.2008 bashke me proces-verbalin) dhe ka percaktuar se pesha totale e mbetjeve urbane eshte 95 295 kg (95.295 ton) ne dite nga 75 ton/dite te parashikuara ne kontrate , duke u vertetua pretendimi i ngritur nga pala paditese, qe do te thote se volumi i punes se kryer nga pala paditese ne cilesine e sipermarrjes eshte rreth 20 ton/dite, me shume nga sa parashikohej ne kontrate.

Megjithese sio pasqyrua me lart , nga vete komisioni i pales se paditur,u percakua se sasia e mbetjeve urbane rezultonte nje nje mase shume me te larte se ajo e percaktuar ne kontrate, kjo marredhenie mbeti e pazgjidhur.

Vec sa me siper, perseri ne nje kohe te dyte, nga pala e paditur u ngrit nje komision per te bere verifikimet perkatese. Ne baze te urdherit te brendshem te kryetarit te Bashkise Elbasan me nr.11 prot. date 15.01.2010 me objekt "Mbi percaktimin e peshes ditore te mbetjeve urbane ne qytet", ky komision ka bere dhe dy akt-peshime, konkretisht ne datat 25 dhe 26 janar 2010, nga ku rezultoi se ne dt.25.01.2010 pesha ditore ishte 106.970 kg dhe ne dt.26.01.2010 pesha ditore e mbetjeve urbane ishte 112.740 kg. pra u rivertetua nga vete komisioni i pales se paditur se shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k ka kryer nje pune mbi ate te parashikuar ne kontrate, per te ciler nuk eshte paguar, por qe ne zbatim te detyrimeve kontraktore, eshte kerkuar nga pala e paditur qe te kryhet, ne funksion te mbartjes se qytetit paster .

Rezultoi se te gjitha peshimet e bera nga pala e paditur-Bashkia Elbasan, kane bere te cilet dhe ne perladhat me me pak ngarkese, pasi gjate fundjave dhe ne fundin e veters sasia ditore e mbeturinave urbane eshte shume me e madhe.

Shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k ka realizuar keto volume shtese te puneve te para nga ketyrmet e percaktuara ne nenin 8 te kontrates ku percaktohen detyrimet e sipermarresit, ndas te cilet "Sipermarresi bie dakort te kryeje sherbimin e transportit te mbeturinave urbane si dhe te beje depozitim e mbeturinave te ngurra urbane ne thesh depozitim e percaktuar nga Bashkia ne perputhje me nenin 11 dhe ne "Specifikime Teknike" me kushte dhe afate te parashikuara ne kontrate.

Ne kushtet nges nenin 25 te kontrates, "Mbeturinat urbane do te hiqen çdo dite nga konteneret ne te gjithë territorin qe mbulon Bashkia Elbasan"

Ne kane te shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k. do te transportonte dhe do te sistemonte ne vendgrumbullim vetem sasine e percaktuar ne kontrate, kjo do te ishte pasqyra e rrenda ne kryerjen e sherbimit te pastrimit per qytetin e Elbasanit dhe shoqeria mund te penalizohet me gjoba dhe sanksione te tjera me te rrenda, te parashikuara ne kontrate.

Pala e paditur-Bashkia Elbasan e ka pranuar qe sasia e mbeturinave urbane te transportonet dhe sistemohet ne vendgrumbullim nga shoqeria "Victoria Invest" eshte me e madhe se ajo e percaktuar ne kontrate (shkresat nr 1241 prot, nr 1243 prot, nr 1244 prot. Dt 03.05.2010 te Bashkise Elbasan).

Shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k, vec pretendimeve te ngritur me sasine e mbetjeve urbane, ka kerkuar Bashkise Elbasan dhe ndryshimet perkatese ne kontraten e sipermarries qe lidhet me ritjen e pages minimale, pagave referuese, nga ana e Keshillit te Ministrave te R.SH, si dhe shpenzimeve te tjera qe lidhen me karburantin , etj.

Nisur nga fakti qe volumet e punes te percaktuara ne kontrate jane pas te vogla se volumet faktike, Keshilli Bashkiak, me vendimin nr 15 dt 27.02.2007 miratoi nje rritje te fondit vjetor te pastrimit te qytetit te Elbasanit ne masese 110% e shprehur kjo ne buxhetin e vitit 2008, vendimi i cili nuk eshte zbatuar nga ana e Bashkise Elbasan, e per kete fakt pala paditese, shoq. "Victoria Invest" ne tere pretendon se ka krijuar humbje pasurore (financiar).

Me dt 01.03.2010, Bashkia Elbasan ka miratuar "Shtese Kontrate" me vleren 12 339 282 leke (afersisht 19.5 % shtese kontrate) ne te cilen tonazhi i mbeturmban urban u rrit me 22.3 ton/dite, por humbja pasurore qe eshte shkaktuar nga paditese nga puna e bere , mund te rregullohet vetem nga instituti i begatimit pa shkak.

Sic rezultoi e provuar ne gjykim, pala paditese shoq. "Victoria Invest" sh.p.k , ka permbushur te gjitha detyrimet kontraktore qe rrjedhin nga kontrate e siper marrjes dt 15.09.2006, e fiksuar ne vleren e pergjitheshme 33 401 718 leke ne vit, kontrate e cila eshte e lidhur per nje afat 5 vjecar . Lidhur me pjesen tjeter te punes se kryer nga pala paditese ato nuk gjene mbeshtetje ne kontrate , se per analizua me siper eshte realizuar plotesisht , por ne rastin konkret gjykata omor te ndodhemi perpara nje demit me natyre jashte kontraktore qe eshte shkaktuar nga paditese .

Nga shqyrtimi i provave te paraqitura ne gjykim dhe pretendimeet e palave ne seance gjyqesore, arrihet ne perfundimin se mes paleve ndergjyqese nuk ka asnje shkak ligjore tjeter vec institutit te "**begatimit pa shkak**". mbi te cilin mund te rivendosen te drejtat pasurore te cenuara paleve paditese

Ne nenin 655 te Kodit Civil parashikohet se, "*Personi qe pa nje shkak te ligjshem, ka fituar ose ka kursyer dicka ne dem te nje personi tjeter, detyrohet te shperbleje kete te fundit per humbjet pasurore qe ka pesuar, brenda cogeve te begatimit*", ndersa ne nenin 658 te Kodit Civil parashikohet se, "*Padia per begatimin pa shkak nuk mund te ngrihet kur i demtuarit mund te agreeje ne tate padi per te kerkuar shperblimin e demit te pesuar* "

- Begatimi pa shkak i nje personi duhet kuptuar si shkak i pasurise qe demtuesi ndodhe kur personi i pasuruar fiton nje te drejte pasurore qe nuk ekzistonte ne pasurine e tij . Pasurimi i nje personi ne dem te nje tjetrit mund te ndodhe si rezultat i veprimeve te vete te demtuarit , por mund te ndodhe dhe si rezultat i veprimeve te nje te treti , apo dhe nga vete vete veprimet e kryera nga i begatuar pa shkak. Por qe te ndodhe ky begatim , keto veprime ne odo rast duhet te jene te fajshme , sepse ne te kundert do te ndodhemi perpara institutit te shkakimit te demit .

Kursimi i pasurise ne dem te nje tjetri do te thote se pasurimi i te begatuar nuk paskohet , megjithese do te duhej te paksolhej

Në rezultat nga provat e administruara në gjykim, pala paditese ka përmbushur plotësisht detyrimet dhe objektin e kontrates së sipërmarrjes dt 15.09.2006, duke zbatuar me përpikëri kërkesat e përcaktuara në nenet 5, 6 dhe 7 të saj që lidhet me sasinë e largimit dhe transportimit të mbeturinave urbane (në ton) , si dhe vlerën e punës e pasqyruar cmin. Duke qenë se vlera e punës shtese (sasia e mbeturinave , larguar , transportuar) , ka qenë shumë here me e madhe se ajo e përcaktuar në kontratë , kjo vlerë përben pasuri e cila në rastin konkret është kursyer nga entitë prokurues, Bashkia Elbasan, pasuri e cila duhej të ishte pakësuar entitë prokurues dhe ky subjekt (Bashkia Elbasan) ka kursyer në dem të palës paditese.

Per te mundur detyrimin , qe rrjedh nga begatimi pa shkak duhet qe begatimi te jetë personi te ndodhë në dem të një personi tjetër , duke qenë se fitimi ose humbja e pasurisë në të begatuarit dhe humbja e pasurisë së të demtuarit , janë të kundërtuara ndërmjet njëra-tjetërs në mënyrë reciproke . Kjo do të thotë se pa u përcaktuar pasuria - të demtuarit nuk mund të ketë begatim pa shkak .

Gjykata konstaton se në rastin konkret ekziston lidhja shkakësore , mes demtuarit të palës paditese , shoqë " Viktoria – Invest" , dhe përfitimit të realizuar nga pala e paditur Bashkia Elbasan . Pala paditese ka realizuar volume shtese të përcaktuara në nenet 5, 6 dhe 7 të kontrates së sipërmarrjes për të cilat nuk ka përfituar asnjë shtese të bonusit nga pala e paditur , në kohë që kjo e fundit ka përfituar nga pala paditese shërbimin në mënyrë të plote , në funksion të qëllimit për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes.

Per te përcaktuar volumet shtese si dhe për të krahasuar ato me volumet e punës dhe shërbimet e kryera sipas kontrates (nenet 5, 6 dhe 7) , nga ana e gjykatës, *me vendim të ndërmjetëm, në bazë të nenit 224/a dhe vijues K.Pr.Civile, gjykata caktoi një grup (tre) ekspertesh, (eksperte kontabel dhe mjedisi) të cilet në bazë të detyrave të dhëna për piluan aktin e ekspertimit të paraqitur në seancën gjyqësore të datë 05.01.2011.*

Sipas aktit të ekspertimit (pjesë e dosjes gjyqësore) u përcaktua se për periudhën 2006 dhe në vazhdim, në zërat "largim dhe transportim i mbeturinave urbane" dhe "sistemim i mbeturinave urbane në vendgrumbullim" sasia e mbeturinave urbane është jo më pak se 120 ton/dite nga 75 ton/dite të përcaktuara në kontratën fillestare. Në këtë mënyrë diferencat e rezultuara ndërmjet gjendjes faktike dhe përcaktimeve të vëna në kontratë , përbejnë në vetevetë volumet shtese të punës që pala paditese ka realizuar gjatë sipërmarrjes së saj. Ky konkluzion bazohet në matjet faktike, studime të ndryshme, botime shkencore, referenca etj.

Në aktin ekspertimit përcaktohet se vlera financiare për punën e kryer dhe të paguar nga pala e paditur (për të dy zërat e mësipërm) është 80 030 574 leke – për periudhën nga lidhja e kontrates deri më 5 janar 2011, dhe për çdo ditë pas kësaj date diferencën shtohet me 28 829 leke në ditë.

• Nje kusht tjetër për ekzistencën e begatimit pa shkak është mungesa e shkakut justifikues të asaj që është fituar ose është kursyer. Pasurimi i nje personi duhet të jetë bërë pa ndonjë shkak të ligjshëm, ose për një shkak që nuk është vertetuar apo ligjshmeria e të cilit ka ekzistuar në të shkuarën, por nuk ekziston më në momentin e ndodhjes së përfitimit pasurore nga i begatuar.

Në rastin konkret ekzistenca e një marrëdhënie kontraktore mes paleve nuk kushtëzon ekzistencën ose jo të begatimit pa shkak, pasi kur fitimi ose kursyeri pasurisë së një personi dhe pakesimi i pasurisë së tjetrit, jo përgjigjen qëllimeve ekonomike të marrëdhënieve kontraktore që palët, kanë patur parasysh, begatimi është i justifikuar pikërisht nga kjo kontratë, kurse mungesa e kësaj kontrate është kapërcimi i kufijëve të vullnetit të shprehur nëpërmjet saj, dhe të tjerave të ekzistencës së begatimit pa shkak. Rasti i tillë është marrja e saj që nuk është detyruar, kur midis paleve ekzistojnë marrëdhënie kontraktore të përcaktuara saktësisht.

Përsa i përket këtij kriteri të domosdoshëm të ekzistencës së begatimit pa shkak, gjykata çmon se mes paleve fillimisht ka ekzistuar një marrëdhënie kontraktore e cila ka pasur për objekt *"largimin dhe transportimin e mbeturinave urbane"* dhe *"sistemimin e mbeturinave urbane në vendgrumbullim"*. Për një shkak të ligjshëm mbi të cilin janë krijuar marrëdhëniet juridike mes paleve është përmbushur plotësisht nga pala paditese në gjykim.

Përsa i përket volumeve shtese të kryera nga pala paditese, nuk ekzistojnë asnjë marrëdhënie kontraktore, apo ndonjë shkak tjetër i ligjshëm në bazë të të cilit të realizohet kthimi i gjithë vlerës së punës shtese, tek pala paditese shtesë "Viktoria – Invest" sh.p.k. Në rastin konkret këto punime shtese të kryera nga pala paditese nuk mund të gjejnë mbështetje në dispozitat e sipërcituara, pasi tejkalojnë në një masë të konsiderueshme sasine e konvertuar në vlerë të dhënë në kontratë.

Pasurimi i paleve të paditur Bashkia Elbasan është bërë pa një shkak të ligjshëm (punë shtese të kryera nga pala paditese, për të cilat nuk është paguar), sepse ky shkak ka ekzistuar në të shkuarën dhe vazhdon dhe në momentin e gjykimit.

• Në institutin e begatimit pa shkak, duhet që begatimi i njërit të jetë detyrim i tjetrit subjekt të mos jetë bërë me faj në asnjërin prej formave të tilla. Në rastin konkret pala paditese ka vepruar në kushte të mirëbesimit të plotë ndaj palës së paditur Bashkia Elbasan, pasi kjo shoqëri sic u përcaktua gjatë analizës së rrethësiperme disa here ka vënë në dijeni nëpërmjet shkresave, dhe nga ana tjetër ka zbatuar me përpikëri detyrimet e kontratës për *"largimin dhe transportimin e mbeturinave urbane"* dhe *"sistemimin e mbeturinave urbane në vendgrumbullim"*, me cilesi të lartë.

Ne rastin konkret mungon elementi faj nga pala paditese shoq "Viktoria - Invest" sh.p.k. Dëmtimi që i ka ardhur kesaj pale nga realizimi i volumeve shtese te punes , nuk eshte kryer as me dashje dhe as nga pakujdesia . Pala paditese ka zbatuar me perpikmeri detyrimet e sipermarrjes megjithese sasia e mbetjeve urbane te larguara , transportuara dhe sistemuara ne vend grumbullim, eshte e ndryshme nga ajo e percaktuar ne kontrate.

Ndorse pala e paditur ne menyre te vazhdueshme eshte vene ne dijeni te reutj fakti (nepermjet shkresave te paraqitura si prova ne dosjen gjyqesore) , ne asnje rast nuk e eshte kerkuar nderprerja e punes dhe realizimi i sipermarrjes , pra nderprerja e marredhenieve kontraktore.

Ekzistenca e perbashket e kushteve te mesiperme (referuar perfundimeve te arritura), per qe rregullat e institutit juridik civil te begatimit pa shkak te prezenduara nga pala paditese ne gjykim, te gjejne zbatim dhe te aplikohen nga gjykata ne dhenien e ketij vendimi .

Ne lidhje me pasojat qe rrjedhin nga begatimi pa shkak , gjykata konstaton qe personi i begatuar pa shkak detyrohet te ktheje ate qe ka fituar apo ka kursyer ne dem te jetri . Kjo do te thote se ai do te detyrohet per aq sa eshte begatuar . Ne deratimi te kete rast, lidhet me ate qe eshte fituar ose eshte kursyer nga i begatuari ne kohen e ndodhjes se begatimit dhe jo realizim i nje fitimi ekonomik te njeedhur nga ky begatim.

Ne rastin konkret vlera e demit qe i eshte shkatuar pales paditese , eshte vlera e punes shtese mbi nivelin e cmimeve qe palet kane percaktuar me vullnetin e tyre ne momentin e realizimit te procedures se tenderit dhe nenshkrimtit te kontratave.

Nga ana e eksperteve te baktuar nga gjykata (akt ekspertimit te pergatitur nga eksperte) eshte percaktuar volumet shtese te punes se kryer nga pala paditese , vlera e kryer te punimeve , referuar cmimit per njesi per secilin ze punimesh shtese , dhe vlera totale e tyre qe bertet dhe vleren e begatimit pa shkak te pales se paditese.

Si rezultat i ekspertimit perpiuar nga eksperte te licensuar ne fushen e kredesis dhe ate kontabel , konkludohet se :

Diferenca financiare ndemjet shumes fillestare dhe shumes se ndryshuar qe ka pesua shqeteria jone per volumet shtese te punimeve ne zerat "*largim dhe transportuar i mbetjeve urbane*" dhe "*sistemim i mbeturinave urbane ne vendgrumbullim*" deri ne daten 5 janar 2011 eshte **80 030 574 leke** dhe per çdo dite mbar dates 5 janar 2011 diferenca shtohet me 28 829.2 leke, konkluzion i cili bazohet ne kuadrin ligjore ne fushen e mjedisit, akt peshimet e kryera nga vete pala e paditur ne priridha te ndryshme kohore te cituara dhe gjate analizes se mesiperme te dhe akt peshimet te kryera nga vete ekspertet , te pasyruara dhe te depozituara si prove gjate gjykimit.

Vec sa me siper ekspertet ne perpilimin e aktit te ekspertimit nisur nga kerkimet e pales paditese , kane percaktuar se :

- Diferenca financiare ndermjet shumes fillestare dhe shumes se ndryshuar ka pesuar shoqeria jone nga rritja e pagave minimale dhe pagave referuese me VKM eshte 13 658 135 leke deri ne daten 5 janar 2011 dhe per cdo dite mbas dates 5 janar 2011 diferenca shtohet me 13 392 leke.

Diferenca financiare ndermjet shumes fillestare dhe shumes se ndryshuar ka pesuar shoqeria jone nga rritja e zerit kryesor te kostos "*cmimi i karburantit*" eshte 5 970 638 leke deri ne daten 31.12.2010.

Me padine drejtuar gjykates , pala paditese kerkon qe dhe ndryshimet e pesuara nga rritja e pagave minimale dhe pagave referuese me V.K.M. te shprehin ndryshimet qe kane pesuar zeri kryesor i kostos (*cmimi i karburantit*), pala e paditur Bashkia Elbasan te detyrohet te permbush ketë detyrim pasi rrjedhin ne zbatim te nenit 16 te kontrates se sipermarries, (*ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve*), pretendim te cilin e paraqet ne piken 11 te kerkimit objekt bashkë (***permbushje detyrimi kontraktore***).

Lidhur me kete kerkim gjykata cmon se ne rastin konkret , marredhenia e pagave ndermjet shoq " Viktoria -- Invest " sh.p.k ne cilasne e punedhenesit dhe punonjesve te saj , jane marredhenie qe rregullohen nga K.Punes. Ne kete marredhenie keto marredhenie (ku perfshihet dhe paga) zgjidhen dhe rregullohen midis palave ne zbatim te kerkesave ligjore te percaktuara ne K.Punes dhe te ciles pale e paditur gjykim, shoq " Viktoria – Invest" sh.p.k dhe Bashkia Elbasan.

Sa i perket ndryshimeve qe ka pesuar zeri kryesor i kostos "*cmimi i karburantit*" ,gjkata cmon se ky zeri i kostos eshte perdorur ne funksion te kryerjes se sherbimeve , volumit te punimeve lidhur me sipermarrien e shqerites se " *largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane*" dhe "*mbetjet e mbeturancave urbane ne vendgrumbullim*, qe sic rezultoi gjate gjykimit, jane te kryera ne mase me te madhe nga ajo e percaktuar ne kontraten e sipermarries , pune kryesore per te cilin pala e paditur Bashkia Elbasan eshte begatuar pa shkak . Duke qene se shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k ka realizuar nje volum pune mbi ate te percaktuar ne kontrate me nje diference te konsiderueshme , esate normale qe dhe siperzema e kryera per zerin e kostos "*cmimi i karburantit*" te kene nje diference te konsiderueshme financiare ndermjet shumes fillestare te percaktuar ne kontrate dhe shumes se ndryshuar . Ndaj lidhur kerkimin objekt padi permbushje detyrimi kontraktore , gjykata cmon se ky kerkim eshte i pambeshtetur ne prova e shprehur duhet te rrezohet .

Ne perfundim , gjykata cmon se padia e paraqitur nga pala paditese shoq " Viktoria – Invest " sh.p.k duhet te pranohet pjeserisht , duke u detyruar pala e paditur Bashkia Elbasan te shperbleje kete shoqeri per humbjet pasurore te ardhura si rezultat i begatimit pa shkak te pales se paditur , ne lidhje me kryerjen e

shprehjet dhe volumnin e punimeve të kontratës së sipërmarrjes dt 15.09.2006 , lidhur me punimet e ndërtimit të objektit "largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane" dhe "sistemimin e mbeturinave urbane në vendgrumbullim" , në shumën totale , në vlerën 80 030 574 leke.

Sa më sipër provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe shpjegimet e pjesëmarrësve në proces, aktin e ekspertimit si dhe provat shkresore të ndodhura në dosje e të administruara në seance gjyqësore .

PER KETO ARSYE

shykata bazuar në nenin 305 , 306 të K.PR.Civile

V E N D O S I

Pranimin pjesërisht të kerkese padise së paraqitur nga pala paditëse Shoq "Viktori - Invest" sh.p.k - Elbasan.

Detyrimin e pales së paditur Bashkia Elbasan të shperblejë pales paditëse Shoqëria "Viktoria - Invest" sh.p.k Elbasan , për humbjet pasurore të pesuara që kanë ardhur si rezultat i begatimit pa shkak të pales së paditur , në lidhje me punimet e kryera , largim dhe transportim të mbetjeve urbane dhe sistemim të mbeturinave urbane në vend grumbullim" në vlerën 80 030 574 (tetëdhjetë mijë e tridhjetë mijë e pesqin e shtatëdhjetë e kater) leke.

Rrezimin e kerkese padise për pjesën tjetër .

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të pales së paditur.

Kunder vendimit lejohet ankimi brenda 15 diteve nga e nesërmeja e shpalljes në gjykatën e apelit Durrës . Për palën e paditur Bashkia Elbasan për t'ankim në Tiranë nga dita e komunikimit të vendimit.

Shprehjet e bëra në Elbasan dt 07.04.2011.

SEKRETARE
Taulant Bleda

GJYQTAR
TAULANT TAFI